



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 25.11.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 17.11.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.T. "Agimi- De" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material të shtypur", me Nr. të Prok: 632-20-5688-1-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik N.T. "Agimi- De", e dt. 17.11.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Furnizim me material të shtypur**, me Nr. të Prok: 632-20-5688-1-1-1, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK -së, të datës 12.11.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
- 2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 12.11.2020;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik N.T. "Agimi- De", me datë 17.11.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material të shtypur", me Nr. të Prok: 632-20-5688-1-1-1,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 25.11.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas rishikimit të dokumenteve, autoriteti Kontraktues, konstaton se Operatori Ekonomik NSHT "ERPO-PRINT", i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit.

Sipas Rregullave për tenderë jo-normalisht të ulët, neni 4 pika 4.2, Autoriteti kontraktues nuk e ka konsideruar se Operatori ekonomik NSHT "ERPO-PRINT", ka ofruar çmime abnormalisht të ulëta për tender apo pozicion, prandaj nuk ka shkuar sipas kësaj rregulle.

Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj është eliminuar për arsye se nuk plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**


Faton Gataj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës